

KOSOVO POLICE

MBROJTËSI

Vëllimi XII - Nr. 10 / 2020

... drejtësi për të gjithë



NJËZET E NJË VJET
NJËZET E NJË HERONJ

EDITORIAL



Baki KELANI

Policia e Kosovës si institucion i zbatimit të ligjit, i mbajtjes së rendit dhe sigurisë publike shpeshherë është mburoja e parë për qytetarin në rast rreziku. Është një simbol sigurie për vendin përmes së cilës qytetarët duhet të lidhen ngusht duke besuar bindshëm dhe duke bashkëpunuar shumë për zvogëlimin dhe eliminimin e problemeve që hasin.

Gjatë 21 vjetëve punë, rruga nëpër të cilën kaluam ishte e mbushur edhe me dhimbje.

Policisë së Kosovës, në krye të detyrës i ranë 21 zyrtarë, të cilët e lanë një boshllëk të madh në punën policore, mirëpo ata i dhanë krenari dhe heroizëm organizatës sonë. Ata u bënë heronjtë tanë pikërisht në 21 vjetorin e themelimit.

Duke i kujtuar me krenari, policia merr shembull nga trimëria e tyre, nga guximi dhe nga virtytet e larta që ata patën.

Policia çdo ditë të punës përballlet me sfida të cilat përherë e kalisin për të qenë edhe më të fort gjatë të papriturave të kohës. Me gjithë angazhimet e përditshme policore, tash e gati një vit polica po përballlet edhe me sfidat që i ka sjellë situata me pandeminë 'COVID 19'.

Që nga fillimi i pandemisë, policia ka qenë e detyruar të bëjë plane operative shitesë për ta mbuluar nevojën e qytetarëve për mbrojtje nga virusi. Policia është dashur të bëjë ndryshime edhe në orarin e punës, duke e zgjatur nga 8 në 12 orë, ka punuar me staf të reduktuar, me ndërrim lokacionesh në vende pune, por megjithatë ka dalë e suksesshme në prioritetet e saja.

Policia e Kosovës gjithnjë është e gatshme t'u shërbejë qytetarëve pa dallim moshe, gjinie, kombësie a nacionaliteti vetëm e vetëm që të mbretërojë e mira kundrejt së keqes, të mbizotërojë rendi kundrejt parregullsisë, të ketë paqe përreth nesh.



Revistë e Policisë së Kosovës

Botues:

ZIMP
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie
me Publikun e PK-së
DPP - Prishtinë

Kryeredaktor:
Baki KELANI

Redaktor:
Daut HOXHA

Menaxhimi i dizajnit dhe grafikes:
Çajup KAJTAZI

Lektor:
Leonora FEJZULLAHU - RUHANI

Fotograf:
Arbër MUHADRI

Bashkëpunëtorë:
Dr. Lindita KAJTAZI
Merita CANOLLI - GASHI

Tel:
Tel.: 038 5080 1243
Tel.: 038 5080 1237
Mob.: 044 506 308
Mob.: 044 181 418

E-mail:
baki.kelani@kosovopolice.com
daut.hoxha@kosovopolice.com
zimp@kosovopolice.com

Telefon: 192
info@kosovopolice.com
www.kosovopolice.com
facebook.com/KosovoPolice

KOMANDANTI I USHTRISË AMERIKANE, KOLONEL ERIC RILEY VIZITOI POLICINË E KOSOVËS, 4

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E MIRËKUPITIMIT NDËRMJET POLICISË SË KOSOVËS DHE AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS, 4

MENAXHMENTI I POLICISË SË KOSOVËS NË TAKIM ZYRTAR ME PËRFAQËSUES TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS, 5

MINISTRI VELIU DHE U. D. DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS, Z. MEHMETI U TAKUAN ME DREJTORIN E POLICISË SË SHQITËS TË ITALISË FRANÇO GABRIELLI, 6

POLICIA E KOSOVËS PRANOI NJË DONACION PREJ 15 VETURAVE, 7

DIPLOMON GJENERATA E 55-TË E KADETËVE POLICORË TË POLICISË SË KOSOVËS, 8 TAKIM VIRTUAL I U.D. DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË PK-SË,

Z. SAMEDIN MEHMETI, ME MANAXHMENTIN E LARTË TË PK-SË, 9

ANGAZHIMET E POLICISË SË KOSOVËS NË ZBATIM TË MASAVE ANTI COVID-19, 10-11 MOS HESHT - NDAL TRAFIKIMIN ME NJERËZ, 12

PARANDALIMI I TRENDEVE TË REJA TË DELIKUENCËS SË TË MITURVE DHE KRIMIT, 13 SHËNIMI I DITËS SË BE-SË KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE, 13

KALENDARI 2021, 14-15

LISTA E ZYRTARËVE POLICORË TË RËNË NË KRYERJE TË DETYRËS, 16-17

NJËZET E NJË VJET, NJËZET E NJË HERONJ, 18-19

LANSOHET APLIKACIONI “LAJMËRO POLICINË”

QË LEHTËSON RAPORTIMIN E RASTEVE PËR QYTETARËT, 20

PËRGJEGJËSIA DHE SHPEJTËSIA E PËRHAPJES SË INFORMACIONIT NË PUBLIK, 21 DISA NGA OPERACIONET POLICORE, 22-23

AKTIVITETET VETËDIJESUESE DHE MASAT MBROJTËSE TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE GJATË PANDEMISË COVID-19 PËR PERSONELIN E POLICISË SË KOSOVËS, 24-25

KURIOZITETE, 26-27

LAJMËRO POLICINË, 28

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të disa shkrimeve të këtij botimi nuk paraqesin medeomos qëndrimet ose vështrimet zyrtare të PK-së.

Komandanti i Ushtrisë Amerikane, kolonel Eric Riley vizitoi Policinë e Kosovës

U. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, priti në vizitë zyrtare kolonel Eric Riley me bashkëpunëtorë, komandant i Ushtrisë Amerikane në kuadër të KFOR-it, i cili është në përfundim të misionit të tij, si dhe komandantin e ri kolonel Derek Adams.

U. d. drejtori i Përgjithshëm Mehmeti falënderoi kolonelin Riley për kontributin dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me Policinë e Kosovës.

Kolonel Riley përgëzoi Policinë e Kosovës për punën, profesionalizmin dhe bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë misionit të tij në Kosovë.

Në shenjë mirënjohjeje për nga të dyja palët u ndanë pllaka dhe letër falënderime.

U.d. drejtori i Përgjithshëm konfirmoi përkushtimin e Policisë së Kosovës për vazhdimin e bashkëpunimit dhe punës së përbashkët me Komandën Rajonale të Lindjes.



Nënshkruhet Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës

Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës u nënshkrua Marrëveshja e Mirëkuptimi ndërmjet Policisë së Kosovës dhe

Agjencisë Kadastrale të Kosovës, për qasjen në regjistrin për të drejtat në pronën e paluajtshme dhe sistemin e adresave. U.D. Drejtori i Përgjithshëm i

PK-së, z. Samedin Mehmeti dhe Drejtori Ekzekutivi i AKK z. Avni Ahmeti, potencuan nevojën për thellimin e bashkëpunimit në koordinimin sa më efektiv në fushën e ofrimit dhe përkrahjes reciproke në mes këtyre dy institucioneve.



Menaxhmenti i Policisë së Kosovës në takim zyrtar me përfaqësues të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, u.d. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Samedin MEHMETI priti në takim Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Gjenerallejtënant Rrahman RAMA.

Takimi, kishte një shkas të veçantë, i cili vije pas një ndihme në aspektin mjekësor që ka realizuar FSK-ja, karshi PK-së. FSK-ja-Qendra Mjekësore me personelin mjekësor të saj, ka realizuar një proces të testimeve serologjike për një numër prej 612 (gjashtëqind e dymbëdhjetë) zyrtarëve të PK-së.

U.d. Drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. Samedin MEHMETI, falënderoi Gjenerallejtënant Ramën dhe personelin mjekësor të FSK-së për gatishmërinë për të kryer testimet e një numri të zyrtarëve policorë. Bashkëpunimi mes këtyre dy institucioneve ka qenë i vazhdueshëm, por më herët ka qenë në aspektin operativ e tani po pasurohet edhe në aspektin mjekësor me një ndihmë konkrete të ofruar nga FSK-ja. Bashkëpunimi ndërinstitucional i këtyre dy institucioneve, pos aspektit human në këtë rast, është edhe një lloj ëndrrë



e brezave që të shohin institucione të tilla që bashkëpunojnë në të mirë të atdheut.

Gjenerallejtënant Rama, tha se kemi respekt për uniformën, prandaj këtë aktivitet e kemi zhvilluar me dëshirë, kur kemi parasysh se po bashkëpunojnë mes vete dy institucionet më të besueshme, më kredibile të Republikës së Kosovës. Gjenerallejtënant Rama, shprehu gatishmërinë për bashkëpunime edhe në

të ardhmen dhe me mbështetje në forma të ndryshme për projektet e PK-së, përfshirë ofrimin e përvojave të FSK-së në aspektin e sigurimit të pajisjeve të veçanta që mund t'i shërbejnë PK-së.

Në fund të takimit, u.d. Drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. MEHMETI ndau letër falënderim për Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës-Gjenerallejtënant Rrahman RAMA dhe ekipin mjekësor të FSK-së.





Ministri Velu dhe u. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Mehmeti u takuan me drejtorin e Policisë së Shtetit të Italisë Franco Gabrielli

Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Velu gjatë vizitës në kryeqytetin e Italisë në Romë, së bashku me u.d. Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, janë pritur në takim nga Drejtori i Policisë së Shtetit të Italisë, z. Franco Gabrielli. Me këtë rast ministri Velu ka theksuar se me nënshkrimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Policor, policitë e dy shteteve tona do të kenë një mjet shtesë në dispozicion për të forcuar bashkëpunimin, shkëmbyer përvoja, por më e rëndësishmja forcuar bashkëpunimin bilateral, në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit, terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ministri Velu është zotuar se Policia e Kosovës do të vazhdojë të jetë partneri i besueshëm i Republikës Italiane, ku do të ofrojë bashkëpunim proaktiv, të vazhdueshëm

me qëllim të ruajtjes së sigurisë jo vetëm në të dy shtetet tona, por edhe të rajonit dhe Bashkimit Evropian. Ndërsa drejtori i Policisë së Shtetit, z. Gabrielli vlerësoi bashkëpunimin e deritashëm

me Policinë e Kosovës, veçanërisht në fushën kundër terrorizmit dhe shprehu përkushtimin për avancim të bashkëpunimit në përkrahje për përf forcimin e kapaciteteve të Policisë së Kosovës.



Policia e Kosovës pranoi një donacion prej 15 veturave



Policia Federale e Gjermanisë, në një ceremoni të organizuar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ka bërë dhurimin e një donacioni të rëndësishëm prej (15) veturave për Policinë Kufitare të PK-së.

Pranimi dorëzimi i këtij donacioni u nënshkrua nga u.d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti dhe ambasadori i Gjermanisë z. Jörn Rohde.

Ky donacion sipas z. Mehmeti dëshmon bashkëpunimin e fuqishëm të Policisë së Kosovës me atë të Gjermanisë, në luftimin e krimit të organizuar dhe atij trans-kufitar.

Si shumë të rëndësishëm këtë donacion e ka cilësuar edhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, z. Jörn Rohde, i cili rikonfirmoi bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme për Policinë e Kosovës e në veçanti për Policinë Kufitare.

Pesëmbëdhjetë (15) automjetet që erdhën si dhuratë janë të modelit Duster nga prodhuesi Dacia, veturë kjo e cila dallohet për multi-funksionalitetin teknologjik, ashtu sikurse për qasjen e mirë në terrene të ndryshme pavarësisht vështirësisë, e që janë të nevojshme për

Policinë Kufitare. U. d. drejtori i PK-së, z. Mehmeti, falënderoi ambasadorin gjerman dhe Policinë Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin, përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që shteti gjerman ka bërë dhe po bën ndaj Policisë së Kosovës.



Diplomon gjenerata e 55-të e kadetëve policorë të Policisë së Kosovës



Me 30 tetor 2020, ka diplomuar gjenerata e 55-të e kadetëve policorë të Policisë së Kosovës. Bazuar në situatën aktuale të pandemisë COVID-19 nuk është mbajtur ceremonia e diplomimit. Diplomimi është bërë në grupe të vogla-klasa ,në hapësirat e Akademisë, organizuar nga Drejtoria për Trajnime Themelore-Divizioni i Trajnimeve i Policisë së Kosovës.

Në këtë ngjarje ka marrë pjesë edhe u. d. drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Samedin Mehmeti, i cili ka thënë se sot Policisë së Kosovës po i bashkëngjiten 426 policë të rinj që do të jetë ndihmesë e madhe për punën në terren dhe nga të njëjtit ka kërkuar angazhim shtesë sidomos në këtë kohë të pandemisë. “Duke marrë parasysh se PK-ja ka një imazh të mirë te qytetarët

ju duhet të kontribuoni që akoma më shumë të ngrihet niveli i besueshmërisë te qytetarët. Policëve të rinj ju dëshiroj shëndet dhe suksese në detyrën e re në shërbim të qytetarëve”, thandër të tjera z. Mehmeti. Me këtë rast 426 policët e rinj i pranuan certifikatat dhe dhanë betimin zyrtar se do të zbatojnë Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, se do ta mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së

Kosovës, duke treguar profesionalizëm, përgjegjësi dhe ndershmëri në interes të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Këtë trajnim së bashku me kadetët policorë e kanë përfunduar edhe 5 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga komponenta e Policisë Ushtarake. Gjithashtu janë ndarë mirënjohje për 14 kadetët policorë si kapitenë të klasave dhe 20 kadetëve policorë për rezultatet më të larta të arritura gjatë kohëzgjatjes së trajnimit. Nga data 2 nëntor 2020 policët e rinj do të fillojnë të shërbejnë në kuadër të Policisë së Kosovës, duke vazhduar me pjesën e programit të trajnimit fushor për policët e rinj në stacione policore në kohëzgjatje prej dy (2) vjet nën mbikëqyrje të instruktorëve praktikë/ fushorë të Policisë së Kosovës.





Takim virtual i u.d. drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, z. Samedin Mehmeti, me manaxhmentin e lartë të PK-së

U.d.drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. Samedin Mehmeti, ka mbajtur një takim virtual me drejtorë të departamenteve dhe Drejtorive Rajonale Policore (DRP), përfshirë Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare.

Tema kryesore që u diskutua është situata epidemiologjike në vend e trajtuar në aspektin policor. U.d. drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. Mehmeti, pas një përshëndetje me pjesëmarrësit nga pozita e re, kërkoi angazhime të shtuara të udhëheqësve të DRP-ve në zbatim të ligjit për 'Parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19', pjesa që i përket policisë. Ai, ndër

të tjera kërkoi menaxhim më efikas me personelin policor dhe po ashtu potencoi se diplomimi i gjeneratës së re të PK-së në fundjavë do të jetë një ndihmesë e madhe për punën në teren

dhe kërkoi që policët e ri, të angazhohen menjëherë në teren në dy ndërrime. U.d. drejtori i Përgjithshëm, z. Mehmeti, foli edhe rreth çështjeve logjistike përfshirë furnizimi me vetura të reja


të cilat janë një ndihmesë teknike në kryerjen e detyrave policore. Po ashtu, kërkoi edhe angazhime e aktivitete më të mëdha lidhur me rastet e emigrantëve që vijnë nga vendet e lindjes së afërt. Më pas, në takim prezantuan me fjalime pjesëmarrësit tjerë, drejtorët e departamenteve dhe ata nga DRP-të dhe nga Drejtoritë Policore Kufitare.



ANGAZHIMET E POLICISË SË KOSOVËS



Pamje nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, angazhimet policore në zbatim të masave anti covid-19



Pamje nga drejtoria rajonale e policisë në Ferizaj, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, angazhimet policore në zbatim të masave anti covid-19



Pamje nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, angazhimet policore në zbatim të masave anti covid-19



Pamje nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë-Veri, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, angazhimet policore në zbatim të masave anti covid-19

NË ZBATIM TË MASAVE ANTI COVID-19



Pamje nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, angazhimet policore në zbatim të masave anti covid-19




Pamje nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, angazhimet policore në zbatim të masave anti covid-19



Pamje nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë-Jug, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, angazhimet policore në zbatim të masave anti covid-19



Kamenicë



Viti

Fushatë vetëdijesuese

MOS HESHT - Ndal trafikimin me njerëz



Në kuadër të kampanjës vetëdijesuese kundër trafikimit me qenie njerëzore “MOS HESHT-Ndal trafikimin me njerëz” që është mbajtur në Kosovë, Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Policimit në Bashkësi dhe Preventivë, me datën 26 tetor 2020, ka zhvilluar një aktivitet në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë. Ky aktivitet kishte për qëllim sensibilizimin e brendshëm dhe të jashtëm për parandalimin dhe mënyrën e referimit të rasteve që kanë të bëjnë me veprën e trafikimit me qenie njerëzore.

Në kuadër të kësaj u mbajt një ligjëratë e shkurtër me nxënës, ku u njoftuan rreth kësaj dukurie, e po ashtu u shpërndanë edhe materiale me përmbajtje sensibilizuese si:

1- Kartela me indikator për punë të detyruar, kërkim lëmshës dhe shfrytëzimit seksual të viktimave të trafikimit.

2- Broshurat informuese për nxënës në aspekt të njohjes së formave të veprës penale të TQNJ-së dhe referimit të rasteve.

3- Maska mbrojtëse nga COVID-19 me

moton “MOS HESHT- Ndal trafikimin me njerëz”. Gjatë gjithë kohës sa u zhvillua ky aktivitet u respektuan rekomandimet e IKSHPK-së për mbrojtje nga COVID-19.



Parandalimi i trendeve të reja të delikuençës së të miturve dhe krimit

Drejtoria e Policimit në Bashkësi dhe Preventivë, në përkrahje të misionit të OSBE –së në Kosovë dhe Divizionit të Trajnimeve të PK-së, ka realizuar punëtorinë një ditore me temën: “Parandalimi i trendeve të reja të delikuençës së të miturve dhe krimit”. Qëllimi i punëtorisë në fjalë është ndërgjegjësimi i zyrtarëve policorë për tendencat dhe krimet e reja të delikuençës së të miturve dhe pasojat e tyre në bashkësi.

Përveç kësaj, në këtë seminar pjesëmarrësit patën mundësinë që të marrin informata edhe për risitë në kornizën ligjore (Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve).

Seminari në fjalë u realizua në të gjitha rajonet policore.

Realizimi i seminareve u bë në respektim të plotë të masave anti Covid të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë!



Shënimi i ditës së BE-së Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore

Policia e Kosovës, Drejtoria Kundër trafikimit me Qenie Njerëzore në bashkëpunim me Policinë Kufitare në shenjë të shënimit të ditës së BE-së Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore e cila fillon me 18 tetor, përmes sensibilizimit të brendshëm dhe të jashtëm për mënyrën e referimit të

rasteve që kanë të bëjnë me veprën e Trafikimit me Qenie Njerëzore, ka shpërndarë materiale që i dedikohen:

- Kartela me indikator që bëjnë dallimin në mes të Kontrabandimit dhe Trafikimit me Njerëz për zyrtar policor (versioni në shqip dhe serbisht),
- Broshurat informuese për qytetarë

në aspekt të njohjes së formave të veprës penale të TQNJ-se dhe referimit të rasteve (versioni në shqip dhe serbisht).

Materialet sensibilizuese janë shpërndarë në të gjitha pikat e kalimit kufitare të Republikës së Kosovës që lidhet me vendet fqinje.





TEL: 192 - 080019999

[illegible]

LISTA E ZYRTARËVE POLICORË T

ΓΙΣΤΑ Ε ΣΥΚΤΑΒΕΛΕ ΡΟΓΙΣΟΚΕ J



LAZIM REXHEPI

26/04/1964 - 11/09/2001



DANUSH HASANI

22/06/1967 - 21/08/2003



HAJDAR AHMETI

14/09/1976 - 06/09/2003



SABAHAT

03/01/1968



DRITON MEHANA

12/03/1959 - 25/12/2004



ABEDIN MUSTAFA

26/12/1969 - 19/09/2006



AVNI KASUMI

06/05/1966 - 03/01/2007



TRIUM

05/07/1979



JAHI MALIQI

18.03.1965 - 15.04.2014



NEBIH RAMADANI

24/02/1954 - 03/03/2015



SHEMSI GASHI

07/09/1954 - 23/03/2015



ARMENI

18/02/1993



TË RËNË NË KRYERJE TË DETYRËS LE BËNIE NË KËMBIE LE DELAKË?



TE TOLAJ
- 24/11/2003



ISUF HAKLAJ
29/01/1955 - 29/11/2003



ARSIM RRUSTOLLI
04/02/1975 - 23/03/2004



ILIR LLAPATINCA
10/09/1971 - 13/05/2004



F RIZA
- 30/08/2007



SLAVISA MILOVANOVIC
19/11/1982 - 15/07/2011



MISIN KRASNIQI
27/06/1971 - 26/07/2011



ENVER ZYMERI
03/04/1979 - 26/07/2011



D TRENA
- 28/04/2018



MALSOR DASHI
24/08/1990 - 28/04/2018



IZET DEMAJ
11/02/1976 - 27/12/2018



SAMI THAQI
(30/12/1982 - 28/01/2020)

NJËZET E NJË VJET, N



Policia e Kosovës (PK) me datë 04 shtator 2020 në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës shënoj 21 vjetorin e themelimit të saj, e cila me 06 shtator 1999 u themelua si një ndër institucionet e para në Kosovë.

Policia e Kosovës me një ceremoni të mbajtur sipas standardeve të parapara duke iu përshtatur situatës aktuale nga pandemia, shënoj 21 vjetorin e themelimit të saj, ku të pranishëm ishin, Përfaqësuesi i Presidencës së Republikës së Kosovës z. Bashkim Smakaj, Ministri i Punëve të Brendshme z. Agim Veliu, Ish-Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Rashit Qalaj, Ambasadori i OSCE-së z. Jan Braathu dhe znj. Kimberly nga ICITAP-i Amerikan, të cilët të pranishmëve iu drejtuan me nga një fjalë rasti.

Të pranishëm po ashtu ishin edhe

familjarë të zyrtarëve policorë të rënë në kryerje të detyrës, të cilët me rastin e 21 vjetorit të Policisë së Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës

dekoroi me urdhrin “Hero i Kosovës 19 zyrtarë policorë të rënë në kryerje të detyrës”. Në radhët e Policisë së Kosovës janë 21 zyrtarë policorë të cilët



NJËZET E NJË HERONJ



kanë rënë në kryerje të detyrës, duke mos kursyer as jetën e tyre në ruajtje të rendit e sigurisë publike dhe parandalim të krimit, të cilët janë dekoruar me

urdhrrin “Hero i Kosovës”. Policia e Kosovës do të vazhdojë rrugëtimin e saj në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të saja duke

iu shërbyer qytetarëve dhe vendit. 21 vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës është një ditë e veçantë për secilin pjesëtar të Policisë së Kosovës, për familjarët e pjesëtarëve të Policisë por edhe për gjithë qytetarët e Kosovës.

Policia e Kosovës është një nga institucionet e para të themeluara në Kosovën e pas luftës. Që nga themelimi e deri në ditët e sotme Policia e Kosovës është njëri nga institucionet që ka renditur vendin tonë si një histori suksesi në arenën ndërkombëtare si vend i ri dhe në zhvillim.

Policia është një familje e madhe ku aty hynë zyrtarët policor nga e gjithë bota, sepse të jesh zyrtar policor do të thotë të jesh pran dhe me qytetarin, dhe në luftë të vazhdueshme me krimin dhe keqbehësit.



LANSOHET APLIKACIONI “LAJMËRO POLICINË” QË LEHTËSON RAPORTIMIN E RASTEVE PËR QYTETARËT

PROGRAMI RAPORTIMI DIGJITAL ‘LAJMËRO POLICINË’

Aplikacioni “Lajmëro Policinë” është platformë elektronike, e cila iu mundëson qytetarëve të lajmërojnë të gjitha rastet në Policinë e Kosovës. Policia e Kosovës ofron cilësi të shërbimeve policore, zbatim të ligjit dhe nivel të lartë të sigurisë publike për të gjithë.

Aplikacioni “Lajmëro Policinë” është një alternativë e re, e pakufizuar në kohë, mundësi dhe territor, që brenda pak sekondash qytetari mund të ndajë informacione me policinë.

Aplikacioni ofron transparencë, konfidencialitet, pasi që të gjitha raportimet dokumentohen dhe denoncimi i qytetarëve mund të mbetet anonim, varësisht nga për zgjedhja e vetë qytetarit.

PËRDORIMI I APLIKACIONIT

Qasja në aplikacion bëhet përmes disa hapave-veprimeve:

HAPI 1

Shkarkimi i aplikacionit

Aplikacioni mund të shkarkohet në platformën “Play Store” për pajisjet mobile me sistem operativ “Android”, ndërsa në të ardhmen do të jetë i qasshëm edhe në platformën “iOS”.

HAPI 2

Përzgjedhja e gjuhës

Në këtë faqe mund të bëhet përzgjedhja e gjuhës përmes klikimit në ikonat përkatëse, shqip, serbisht dhe anglisht. Përdoruesit e këtij aplikacioni mbajnë përgjegjësi për të gjitha informacionet qëllimkëqija të lajmëruara në Policinë e Kosovës.

HAPI 3

Pajtimi me kushtet e përdorimit

1. Bëhet përmes klikimit ‘Unë pajtohem me termat dhe kushtet’ duke konfirmuar në butonin Pranoj.

2. Nëse përdoruesit nuk pajtohen me kushtet e përdorimit, atëherë ata nuk

do të kenë mundësi ta përdorin këtë aplikacion.

Policia e Kosovës rezervon të drejtën që të ndryshojë apo të modifikojë kushtet e përdorimit të aplikacionit, në pajtim me ndryshimet e mundshme ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.

Përdoruesit mund të çregjistrohen nga përdorimi i këtij aplikacioni në çdo moment, me ç’rast të gjitha të dhënat e tyre personale të mbledhura për qëllime të ofrimit të aplikacionit do të fshihen në mënyrë automatike.

HAPI 4

Ngarkimi dhe dërgimi i informacionit përmes aplikacionit

Kategoritë e raportimit

Aplikacioni ka shtatë kategori të lajmërimit: dhunë, vjedhje, komunikacion, armë, korrupsion, drogë dhe të tjera.

Të gjitha njoftimet që përmbajnë fotografi, tekste, përshkrime do të ruhen në web sistemin e Policisë së Kosovës, i cili do të përdoret vetëm nga Policia e Kosovës për qëllime legjitime dhe në pajtim me ligjin.

Nëse raportuesi zgjedh një nga kategoritë e raportimeve dhe klikon mbi të, shfaqet ndërfaqja përkatëse e kategorisë së përzgjedhur.

P.sh. Ikona për komunikacion:

Pas klikimit në ikonën “Raporto”, raportuesi do të pranojë njoftimin në mënyrë automatike që informacioni është pranuar dhe është adresuar nga Policia.



PËRGJEGJËSIA DHE SHPEJTËSIA E PËRHAPJES SË INFORMACIONIT NË PUBLIK

Nëse gjatë komunikimit me publikun lëmë boshllëqe, atëherë krijojmë shumë mundësi për interpretime në bazë dëshirash, dhe atëherë besimi zbehet, bie dhe humb interesimi për për t'i përcjellë ngjarjet

Të informosh do të thotë të flasësh për ndodhitë, t'i bindësh njerëzit me fakte, të jesh i shpejtë dhe i saktë. Por, që realizimi të jetë i suksesshëm për të dhënat që i shpërndan, ato duhet t'i veshim me përgjegjësi morale, komunikim të mirëfilltë e kulturë në të shprehur.

Informacioni është çdo lloj lajmi i cili e bën të mundur komunikimin.

Kur e shpërndan një informacion për publikun duhet llogaritur ta mbash peshën e tij. Është mënyra si ti e publikon ajo që ta lehtëson ose ta rëndon atë peshë.

Një lajm i plotë është atëherë kur i ka burimet e sigurta, kur përmban informacione të sakta, kur publikohet në kohë, ka përshkrim të kuptueshëm, ngjall interesim kur del dhe marrësi e ka kuptuar në mënyrën e duhur atë lajm.

Për t'i arritur të gjitha këto karakteristika e për ta dhënë një informacion të plotë së pari duhet pasur durim, duhet pasur maturi shkathtësi e vetëpërmbytje. Duhet të bësh ndërlidhje në mes dhënësve dhe marrësve, të hysh në botën e dy palëve, të arrish të kuptosh nga të dyja anët sepse kështu e kupton a ke arritur ta thuash siç duhet atë që e ke sajuar.

Nëse gjatë komunikimit me publikun lëmë boshllëqe, atëherë krijojmë shumë mundësi për interpretime në bazë dëshirash, dhe atëherë besimi zbehet, bie dhe humb interesimi për për t'i përcjellë ngjarjet.

Shpeshherë në presion të kohës, informacioni mund të dalë i mangët,

por një gjë e tillë nuk duhet lejuar ngase formulimi i informacionit luan rol më këtë mes. Merren fjalët e fuqishme me kuptim, renditen saktë dhe informacioni plotësohet edhe në kohë.

Bota bashkëkohore na ka sjellë shumë mënyra komunikimi dhe sot shpejtësia e publikimit të informacioneve luan rol të madh në botën e medias. Me lehtësimin e komunikimit ka humbur serioziteti i të shkruarit. Sot informacionin mund ta marrësh shpejt, kudo, por me më pak kulturë, me më pak kuptimsi, me më pak përgjegjësi!

Prandaj, informacionet e dala nga institucionet duhet të ndërtohen me bazë, të logjikshme e të bëhen shembull i komunikimit për rrjetet e shpejta të ditëve të sotme.

Një lajm i plotë është atëherë kur i ka burimet e sigurta, kur përmban informacione të sakta, kur publikohet në kohë, ka përshkrim të kuptueshëm, ngjall interesim kur del dhe marrësi e ka kuptuar në mënyrën e duhur atë lajm

Bazuar në ligjin në fuqi, informimi i drejtë është detyrë e secilit institucion.

Përgjegjësia është e të gjithëve!

Merita CANOLLI - GASHI



DISA NGA OPERAC

**Njëmbëdhjetë
persona të arrestuar
për përfshirje në
veprën penale
'importi, eksporti,
furnizimi,
transportimi,
prodhimi, këmbimi
ndërmjetësimi ose
shitja e paautorizuar
e armëve apo
materialeve plasëse'**

Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar (DHKO), pas hetimeve disa mujore, me urdhëresë të lëshuar nga Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti Special, në orët e hershme të mëngjesit të datës 29.09.2020 ka realizuar një operacion policor në rajonin e Pejës. Gjatë këtij operacioni policor, janë kontrolluar shtëpi dhe objekte përcjellëse në 10 (dhjetë) lokacione të ndryshme. Hetuesit e DHKO-së janë përkrahur nga njësitet policore: Njësia Speciale Operative (NJSO), Njësia me qenë -K9 dhe dy njësi të Stacionit Policor Pejë.



Gjatë operacionit janë arrestuar 11 (njëmbëdhjetë) persona të dyshuar.

Gjate kontrollit, si prova materiale janë gjetur dhe sekuestruar:

- 3 (tre) armë të gjata gjysmë-automatike,
- 6 (gjashtë) armë të vogla,
- 2 (dy) karikatorë
- 1 (një) dylbi,
- 180 fishekë (kalibër të ndryshëm),
- 2000 (dymijë) euro,
- 2 (dy) vetura dhe
- 12 (dymbëdhjetë) telefona mobil.

Me aktvendim të prokurorit kompetent, njëmbëdhjetë të dyshuar janë dërguar në mbajtje për 48 orë.

**Policia e Kosovës
arreston të dyshuarin
për veprën 'falsifikim
i parasë'**

Policia e Kosovës në perpjekjet e saj për luftimin e dukurive negative dhe veprave penale, pas hetimeve të zhvilluara me datë 23.09.2020, ka bërë arrestimin e një personi të dyshuar për veprën penale "Falsifikim i parasë".

Policia e Kosovës përmes rrugëve operative me datë 16.09.2020 ka pranuar informacione se një person i dyshuar është duke prodhuar para të falsifikuara në bankënota të ndryshme si : 5 (pesë), 10 (dhjetë) dhe 20 (njëzet) euro.

Njësia për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit – Prishtinë ka ndërmarrë veprime të menjëhershme hetimore dhe operative, ku dhe është kuptuar se personi i dyshuar me inicialet L.A mashkull/kosovar është në përgatitje të një shume prej 50.000 euro para të



falsifikuara, për t'i lëshuar në treg. Në lidhje me rastin është kontaktuar prokurori kompetent dhe gjyqtari i procedurës ku nga dhe është dhënë urdhëri verbal për kontrollim të lokacionit ku dyshohej se po prodhoheshin paratë e falsifikuara.

Gjatë realizimit të kontrollit në lokacionin e dyshuar njësitë policore kanë gjetur dhe sekuestruar :

- Një printer së bashku me pesë (5) euro të ngjitura në faqen printuese,
- Gjashtëdhjetë e pesë (65) copa letër A4 me para të falsifikuara në të dy anët,
- Dyqind e dy (202) copa letër A4 me nga pesë (5) euro në të dy anët,
- Katër dhjetë e katër (44) kartëmonedhë nga 20 euro që dyshohet se janë të falsifikuara,
- Shtatëdhjetë e katër (74) kartëmonedha nga 10 euro që dyshohet se janë të falsifikuara,
- Njëqind e gjashtëdhjetë (160) kartëmonedha nga 5 euro që dyshohet se janë të falsifikuara,
- Një (1) kartëmonedhë prej 50 euro që dyshohet se është e falsifikuar,
- Foli me shenjë të sigurisë së parave dhe
- Dy telefona celular.

Pas kontrollit i dyshuari është arrestuar dhe i njëjti është intervistuar, në konsultim me prokurorin kujdestar të PTH-Prishtinë, i dyshuari dërgohet në ndalim për 48 orë.

ACIONET POLICORE

Policia në Gjakovë zbulon vendin ku kultivoheshin bimë, që dyshohet të jenë kanabis-sativa



Policia e Kosovës, gjegjësisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotik-Gjakovë, ka pranuar njoftimin se në një shtëpi në Gjakovë, kultivohen bimë kanabis sativa. Më 30.07.2020, në ora 10:35, në konsultimi me prokurorin kujdestar dhe pas marrjes së urdhrit verbal nga Gjykata Themelore Gjakovë, ka filluar kontrolli i shtëpisë në prezencë të dy dëshmitarëve.

Gjatë kontrollit në pjesën e bodrumit të shtëpisë, është gjetur një lloj laborator me ventilim, me drita të posaçme dhe pjesë tjera që shërbejnë për kultivimin e bimëve kanabis sativa.

Si dëshmi materiale nga policia, janë konfiskuar:

- Katërbëdhjetë (14) vazo me bimë (dyshohet të jenë anabis sativa) me gjatësi 90-160 cm,
- Njëmbëdhjetë (11) bimë në proces të tharjes (dyshohet të jenë anabis sativa) të gjetura në tavan të shtëpisë,
- Katër (4) shishe (nga 1.5 dhe 2 litra) të mbushura me lëngë që dyshohet të jetë



vaj kanabisi,

- Dy (2) tenda (sera) për kultivim të bimëve kanabis sativa, dy (2) rregullator të rrymës së bashku me drita, dy (2) freskuese të ajrit, një (1) ventilator dhe një (1) termometër për matje të temperaturës, dhe

- Gjashtë (6) fishekë të armës kalibri i panjohur.

Në vend-ngjarje ka dal prokurori kujdestar i Prokurorisë Themelore Gjakovë i cili ka udhëzuar që të iniciohet rasti ‘kultivim i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit’ dhe ‘armëmbajtje pa leje’.

Arrestohet një person i dyshuar i cili tentoi të hyjë në Kosovë, duke fshehur dhe transportuar substancë narkotike

Me datën 10.08.2020 rreth orës 11:20, Policia e Kosovës, në këtë rast zyrtarët kufitar në pikën kufitare Vërmicë, gjatë regjistrimit në sistem të automjetit “Seat” me targa lokale i cili ishte duke hyr nga Shqipëria për në Kosovë, të njëjtin kanë vendosur ta selektojnë për kontroll të detajuar në vijën e dytë të kontrollit.

Gjatë kontrollimit të hollësishëm të ushtruar nga ana e zyrtarëve policor në bashkëpunim dhe koordinim me oficerët doganor, në pjesën e përparme tek motori i automjetit janë gjetur pesëmbëdhjetë (15) qese najloni të mbushura me substancë të dyshuara narkotike e llojit marihuanë, me peshë e cila dyshohet të jetë prej rreth 6kg.

Në lidhje me rastin është njoftuar drejtoria për hetimin e trafikimit me narkotik, njësia e forenzikes, dhe njësitet tjera relevante për trajtim dhe hetim të mëtejme të rastit.

Me urdhër të Prokurorit të Prokurorisë Themelore DKR Prizren, është iniciuar rasti për veprën penale “Blerja, Shpërndarja, Transportimi, Prodhimi, Këmbimi, Ndërmjetësimi ose Shitja e paautorizuar e Substancave narkotike dhe psikotrope ose analoge”, ndaj të dyshuarit (E.L. viti i lindjes 1966).

Të gjitha veprimet ndaj personit të dyshuar, janë ndërmarr në bashkëpunim dhe koordinim me Prokurorin kompetent.



AKTIVITETET VETËDIJESUESE DHE MASAT M SHËNDETËSORE GJATË PANDEMISË COVID-19

I. Aktivitetet vetëdijësuese të Policisë së Kosovës ndaj COVID-19

Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore/DPP, në kuadër të objektivës specifike të punës:

“Kujdesi shëndetësor dhe psikologjik për pjesëtarët e PK-së”, ka realizuar aktivitete që kanë për qëllim vetëdijësimin për kujdesin shëndetësor dhe psikologjik për personelin e Policisë.

Duke marrë parasysh situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore/DPP, ka filluar të ndërmarrë disa aktivitete vetëdijësuese, ende pa u shpallur gjendja emergjente e shëndetit publik, në nivel të Qeverisë së vendit.

Aktivitetet vetëdijësuese nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore/DPP, kanë filluar në muajin shkurt 2020, të cilat janë si në vijim:

1. Ligjërata “Si të mbrohem nga Koronavirusi”
2. Posterët “Jo frikë, por kujdes të shtuar për COVID-19”
3. Broshura “Koronavirusi dhe shëndeti mendor”

Qëllimi: Aktivitetet vetëdijësuese janë ndërmarrë për të informuar dhe për të njoftuar personelin policor rreth virusit më të ri në botë, i cili po shkakton një sëmundje të quajtur COVID-19, se si të mbrohem nga ky virus, cilat masa parandaluese duhet t’i zbatojë secili punonjës në PK, duke u bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës –IKSHPK.

Qëllim tjetër ka qenë edhe menaxhimi i ankthit dhe panikut ndaj diçkaje të panjohur deri më tani dhe ballafaqimi me situatat e tilla që shkaktojnë luhatje në sferën psikologjike dhe emocionale.

1. Ligjërata “Si të mbrohem nga Koronavirusi” është mbajtur fillimisht me përqendrim më të madh në pikat kufitare, sepse në fazën fillestare të pandemisë COVID-19, pjesëtarët e PK-së në pikat kufitare kanë qenë më të rrezikuar, për shkak të ardhjes së udhëtarëve nga shtete të ndryshme të botës të prekur nga COVID-19.

Qëllimi: Ligjërata në fjalë ka ofruar sqarime dhe këshilla profesionale rreth natyrës së SARS-COV-2 dhe rreth masave parandaluese që duhet ndërmarrë për mbrojtje nga COVID-19, sipas udhëzimeve të IKSHP-së.

2. Posterët “Jo frikë, por kujdes të shtuar për COVID-19” janë përgaditur bazuar në udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe janë shpërndarë në Policinë Kufitare, në dy kampet e Njësisë Speciale të PK-së, në të gjitha Drejtoritë Rajonale të PK-së, në Drejtorinë e Trajnimeve Themelore (me theks për kadetët policorë) dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të PK-së /DPP.

Qëllimi: Posterët senzibilizues “Jo frikë, por kujdes të shtuar për COVID-19” kanë ndikuar që personeli i Policisë të jetë i vetëdijësuar rreth masave parandaluese të COVID-19, sipas udhëzimeve të IKSHPK-së.

3. Broshura “Koronavirusi dhe shëndeti mendor”

Broshura “Koronavirusi dhe shëndeti

mendor” është shtypur në 1400 ekzemplarë, në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe është shpërndarë në gjithë Policinë e Kosovës.

Qëllimi: Broshura “Koronavirusi dhe shëndeti mendor” ka ndikuar në informimin e personelit policor rreth ndikimit emocional e psikologjik që shkakton COVID-19, si dhe masat që duhet ndërmarrë për të ruajtur shëndetin mendor të personelit të Policisë së Kosovës.

II. Komiteti për koordinim dhe vlerësim të situatës emergjente me virusin COVID-19

Të gjitha rekomandimet, udhëzimet, PSO-të e dala nga ky komitet, janë përcjellë me kohë nga DSHSH/DPP tek menaxhmenti i lartë i PK-së, qendra komanduese DPP, Zyra e Informimit DPP dhe tek të gjitha Drejtoritë Rajonale të PK-së, pra komiteti përmes përfaqësimit tonë ka pasur një rol dhe rëndësi të veçantë, duke qenë edhe si urë lidhëse e PK-së dhe MSH-së.

III. Masat mbrojtëse të Policisë së Kosovës ndaj COVID-19

1. Përkrahja shëndetësore ndaj zyrtarëve të Policisë me risk të lartë ndaj COVID-19

Me autorizim nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, DSHSH/DPP ka identifikuar zyrtarët e PK-së, të cilët kanë sëmundje me risk të lartë ndaj COVID-19, duke ofruar mbështetje ndaj personelit policor me këto sëmundje (diabet, sëmundje të zemrës, përfshirë

MBROJTËSE TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE 9 PËR PERSONELIN E POLICISË SË KOSOVËS

edhe tensionin e lartë të gjakut, sëmundje të veshkave, sistemit respirator etj.) me rekomandim për qëndrim në shtëpi, duke ndikuar në parandalimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19 dhe me ndikim direkt në mbrojtjen e shëndetit të zyrtarëve policorë, marrë parasysh se kanë qenë më të rrezikuar të infektohen nga SARS-COV-2 dhe të kenë pasojë më të rënda vdekjeprurëse.

2. Dezinfektimi i të gjitha objekteve policore
Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore/DPP me qëllim parandalimit të përhapjes së COVID-19, ka hartuar planin e veprimit për dezinfektimin dhe dezinfektimin e të gjitha objekteve policore në mbarë Kosovën.

Qëllimi: Dezinfektimi me ndihmën e lëndëve kimike, fizike apo biologjike, ka qenë asgjësimi i mikrobëve, virusëve që shkaktojnë sëmundjen në mjedisin ku jeton dhe vepron njeriu.

3. Furnizimi i zyrtarëve policorë me mjete mbrojtëse (maska mbrojtëse, dorëza një përdorimëshe, dezinfektues ndaj COVID-19).

Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore/DPP me qëllim të mbrojtjes së të gjithë personelit policor nga COVID-19, ka ndërmarrë masat mbrojtëse për të furnizuar zyrtarët policorë me mjete mbrojtëse si: maska mbrojtëse, dorëza,



dezinfektues, me theks të atyre zyrtarëve policorë që kanë qenë në terren dhe ekspozimit direkt të rrezikut me COVID-19.

Donatorë të mjeteve mbrojtëse kanë qenë fillimisht vetëm nga Ministria e Shëndetësisë (MSH), pastaj nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE),

Bashkimi Evropian (BE).

Qëllimi: Furnizimi i personelit policor me mjete mbrojtëse, ka qenë shkak se rrugë hyrëse e virusit janë rrugët e sipërme të frymëmarrjes, prandaj kjo ka ndikuar në ruajtjen e shëndetit të tyre nga COVID-19.

IV. Gjurmimi epidemiologjik

Që nga momenti i shpalljes së gjendjes emergjente të shëndetësisë publike dhe lajmërimi i rasteve të para të konfirmimit të pacientëve me COVID-19 në Kosovë, kemi filluar me gjurmimet epidemiologjike të të gjitha rasteve që janë paraqitur në Kosovë. Janë bërë gjurmime epidemiologjike dhe janë dhënë

rekomandime për vetëizolim.

Qëllimi: Gjurmimi epidemiologjik është hulumtimi drejt identifikimit të vatrës së infeksionit, identifikimi i personave bartës të infeksionit, kontakteve direkte dhe indirekte të tyre si dhe izolimi i tyre, në favor të shpërndarjes së përhapjes së infeksionit tek personat e tjerë.

Përgatiti:
Dr. Lindita KAJTAZI

KURIOZITETE



Disa truke si të dalloni artikujt e falsi kuar

Në ditët e sotme, artikujt dhe produktet e falsifikuara po qarkullojnë gjithmonë dhe më shumë. Megjithatë, është shumë e vështirë që të dalloni një produkt të tillë pasi shpesh duket sikur nuk ka asnjë ndryshim. Bright Side ka renditur disa truke dhe këshilla të thjeshta që ju vijnë në ndihmë të dalloni gjëra e falsifikuara.

Kontrolloni metalin në orët e shtrenjta.

Vendosni orën afër veshit tuaj dhe nëse dëgjoni ndonjë tingull, është më mirë ta lini. Gjithashtu gdhendjet në orët e bukura janë zakonisht më të mprehta. Orët që nuk janë origjinale zakonisht bëhen me materiale më të lira dhe më të lehta.

Kontrolloni logon

Karikueset e falsifikuara nuk janë vetëm të cilësisë së dobët, por ato mund edhe të jenë të rrezikshme për shkak se ata nuk kalojnë certifikimin e duhur. Kontrolloni logon origjinale në telefon me atë të karikuesit: ka një ngjyrë të verdhë në vend të bardhës dhe plastika duket më e dobët.

Kontrolloni qepjen tek rrobat dhe këpucët.

Cilësia e veshjeve origjinale dhe të shtrenjta gjithashtu ndryshon. Qepja do të jetë më e fortë në artikuj autentik, ndryshe nga të tjerat. Veshjet dhe këpucët origjinale shpesh kanë më shumë qepje.

Kontrolloni etiketat në rroba.

Gjithmonë kontrolloni etiketat. Ata mund të thonë shumë nëse marka është e falsifikuar apo jo. Prodhuarit e rremë zakonisht përdorin pajisje fabrike me cilësi më të ulët, kështu që etiketat dhe etiketat mund të qepen keq. Gjithashtu etiketa do të jetë me një ngjyrë tjetër dhe me cilësi të dobët në krahasim me pjesën origjinale dhe shkronjat në të mund të kenë hapësirë të ndryshme.

Kontrolloni kopsat.

Nëse dëshironi të blini një xhakë apo pallto kushtojini vëmendje butonave nga brenda dhe jashtë. Markat e mira përdorin plastikë me cilësi të mirë me emrin e ndërmarrjes të gdhendur. Falsifikimet përdorin plastikë të lehtë dhe nganjëherë do të jenë të pa etiketuara.



“Vodhi” rërë në një plazh italian, turisti francez gjobitet

Një ngjarje e pazakontë ka ndodhur në Itali. Një turist francez u gjobit me 1,000 euro, pasi u përpoq të largohej nga Sardenja me më shumë se 1.8 kilogram rërë në bagazhet e tij.

Sipas CNN, rëra e bardhë e ishullit italian është e mbrojtur me ligj ndërsa turistët mund të përballen me gjoka dhe madje me burg për marrjen e saj nga plazhet lokale.

Burri i cili nuk u identifikua me emër, u kap në Aeroportin e Cagliari Elmas, më 1 shtator pasi vodhi 1.8 kilogram rërë të cilën e kishte vendosur në një shishe. “Shishja u konfiskua dhe gjendet aktualisht në sallën tonë”, u shpreh një zëdhënës për CNN.

Ndërkohë, në vitin 2017 u prezantua një ligj rajonal i cili e bëri të paligjshme heqjen e rërës nga plazhet e Sardenjës në Itali.



Ky person u dënua me 30 vjet burg, arsyeja krejt e pabesueshme

James Robert Scott është një nga të burgosurit që pritet të lërë qelinë në vitin 2023. Mirëpo arsyeja se pse ai qëndroi në burg 30 vite është shumë interesante. I njohur ndryshe me emrin Jimmy, në vitin 1993 në Missouri, ai vendosi të shkatërronte një pjesë të argjinaturës të lumit Mississippi për të përmbytur rrugën dhe për të bllokuar bashkëshorten e tij Suzie, e cila punonte nga ana tjetër e lumit, me qëllim që të bënte një festë dhe të pinte me shokët. Por ky veprim i tij nuk shkoi edhe aq mirë, pasi që dëmi ishte shumë i madh. U përmbytën mbi 57 kilometra katrorë tokë dhe gjithashtu u bë i pamundur përdorimi i një ure për 71 ditë. Pra më shumë se 14 mijë hektarë tokë ishin nën ujë dhe kjo ishte një dëm i madh financiar, me qindra mijëra dollarë. Në këtë mënyrë, ai përfundoi në burg duke u dënuar me 30 vjet heqje lirie. Ai pritet që në vitin 2023 të lirohet nga burgu.



A e dini sa herë duhen rimbushur shishes plastike të ujit?

Shishes plastike për fat të keq përmbajnë Bisfenol A, një substancë kimike që lëlshohet në ujë dhe kthehet në strehën e shumë baktereve të rrezikshme.

Në një përdorim të vetëm, këto baktere mbledhen pikërisht në grykën e shishes, aty ku vendosim buzët, ndaj mund ta imagjinoni se çfarë ndodh me ripërdorimin e këtyre shisheve.

Gryka e shishes nuk pastrohet dot kurrë mjaftueshëm dhe mbetet gjithmonë e lagësht duke u kthyer në një 'pistë vallëzimi' për bakteret.

Kjo substancë kimike ka një ndikim tepër të rrezikshëm tek hormonet e njeriut, sidomos kur shishja ngrohet nga dielli ose ripërdorimi.

Për pasojë, ekspertët e Agroweb.org rekomandojnë që nëse u jepet mundësia, të mos blini shishe uji nga ato që kemi parë rëndom të ekspozuara jashtë në diell për orë të tëra në shumë markete të vendit.

Ekspertët këshillojnë përdorimin vetëm një herë të shishes plastike dhe zëvendësimin e saj me shishe qelqi. Në këtë mënyrë, ju do të mbronin jo vetëm shëndetin tuaj por edhe ambientin ku jetojmë.

Pse rrobat e palara nuk duhen lënë në të njëjtën dhomë për më shumë se një ditë

Ka ndodhur shumë herë që të lini në një karrige në dhomën ku flini, rroba të destinuara për larje. Kjo mund të duket krejt normale, por që shkakton probleme për shëndetin tone.

Sipas ekspertëve, aromat e njeriut që mbeten në rrobat e palara vepron si një "magnet" për marimangat dhe shumë insekte edhe nëse nuk i shohim me sy të lirë. Sipas një studimi të ri nga ekspertët nga Universiteti i Sheffield, rrobat e palara që hedhim në dhomën e gjumit ose dhomën e hotelit janë një magnet për insektet.

Studiuesit që janë marrë me këtë temë arrijnë në përfundimin se ne duhet t'i fusim

rrobat në një shportë dhe mos t'i lëmë atje për shumë ditë. Nëse po udhëtoni dhe po qëndroni në një hotel tani, është më mirë t'i paketoni ato në një qese derisa t'i lani.



A e dini për sa kohë mund të rrijë zgjuar një njeri?

Një njeri rri zgjuar mesatarisht për afro 16 orë e 10 minuta përpara se të bjerë sërish në gjumë. Ata që rrinë zgjuar shumë më tepër dhe si pasojë flenë më pak gjumë, konsiderohen persona me mungesë gjumi në kuptimin mjekësor.

Sipas ekspertëve, të rrish 24 orë pa gjumë zvogëlon aftësinë e trurit për të marrë informacione me 40%, dhe simptomat që shfaqen pas 48 orësh i ngjajnë atyre të një sasive alkooli në gjak, prej 0.15%. Mungesa e gjumit mund të jetë edhe fatale pas 10 deri 14 ditësh.

Mungesa e gjumit pranohet vetëm nga ushtarët e skuadrave elitë si gjë normale, por edhe ata vjen një moment pësojnë lodhje të dukshme, fatkeqësisht me gjithë performancën e tyre.

Info.

Numrat e Stacioneve Policore

Rajoni i Prishtinës

Drejtoria Regionale Prishtinë	038540021
Trafiku Rajonal Prishtinë	038534234
Stacioni Policor Obiliq	038561600
Stacioni Policor Fushë Kosova	038535812
Stacioni Policor Graçanica	038564292
Stacioni Policor Lipjan	038581010
Stacioni Policor Drenas	038/584092
Stacioni Policor Podujevë	038571805
Stacioni Policor Veriu	038249942
Stacioni Policor Jugu	038549924
Stacioni Policor Qendra	038502223
N/Stacioni Policor Orllan	038614972
N/Stacioni Policor Bernicë	038515092
N/Stacioni Policor Magure	038502472
Nenstacioni Policor Janjevë	038567009

Rajoni Peja dhe Gjakova

Drejtoria Regionale Pejë	039 432327
Drejtoria Regionale Gjakovë	038 504504-5510
Stacioni Policor Pejë	039 433273
Trafiku Rajonal Gjakovë	0390 323784
Trafiku Rajonal Pejë	039 432595
Stacioni Policor Gjakovë	0390 322482
Stacioni Policor Istog	039 451374
Stacioni Policor Klinë	039 471199
Stacioni Policor Deçan	0390 361020
Stacioni Policor Rahovec	029 277913
Stacioni Policor Malishevë	038 269007
Nën Stacioni Policor Gorazhdëvë	039 467389
Nën Stacioni Policor Junik	0390 370092
Nën Stacioni Policor Vitomiricë	039/442 203
Nën Stacioni Policor Ponashevë	0390 370888

Rajoni i Mitrovicës

Drejtoria Regionale Mitrovicë	028/532 366
Njesia e Trafikut Rajonal Mitrovicë	028 532 628
Stacioni Policor Mitrovicë Jugu	028 532 585
Stacioni Policor Skenderaj	028/582 087
Stacioni Policor Vushtri	028/572 010
Stacioni Policor ZubinPotok	028 461 042
Stacioni Policor Zveqan	028 665 130
Stacioni Policor/Regjioni Mitrovicë Veri	028 425 170
Stacioni Policor Leposaviq	028/83 424
Nën Stacioni Policor Prilluzhe	028 573 509

Rajoni i Prizrenit

Drejtoria Regionale Prizren	029/244 355
Trafiku Regional Prizren	029/244 655
Stacioni Policor Suharekë	029/271 024
Stacioni Policor Dragash	029/281 017
Nënstacioni Policor Sredskë	038/502 575
Nënstacioni Policor Mushisht	029/275 105
Nënstacioni Policor Mamushë	029/273 453
Nënstacioni Policor Zhur	029/625 092

Rajoni i Gjiçanit

Drejtoria Regionale Gjiçan	0280/330 188
Stacioni Policor Gjiçan	0280/330 061
Trafiku Regional Gjiçan	0280/330 091
Stacioni Policor Novobërda	038/576 092
Stacioni Policor Viti	0280/381 513
Stacioni Policor Kamenica	0280/372 390
Nënstacioni Policor Klokot	0280/381 094
Nënstacioni Policor Ranillug	038/504504-7878
Nënstacioni Policor Zheger	0280/386 011
Nënstacioni Policor Pozharan	0280/386-269
Nënstacioni Policor Muqiverrë	0280/ 320 197

Rajoni i Ferizajit

Drejtoria Regionale Ferizaj	0290/ 322 406
Stacioni Policor Ferizaj	0290/ 327 412
Trafiku Regional Ferizaj	0290/ 321 899
Stacioni Policor Shtërpçë	0290/ 70092
Stacioni Policor Kaçanik	0290/380 834
Stacioni Policor Hani i Elezit	0290/385 015
Stacioni Policor Shtime	0290/389 008



POLICIA E KOSOVËS
POLICIJA KOSOVA
KOSOVO POLICE

PROGRAMI RAPORTIMI DIGJITAL **APLIKACIONI ‘LAJMËRO POLICINË’**

MUNDËSI AL-
TERNATIVE E
KOMUNIKIMIT TË
QYTETARIT ME
POLICINË PËR
LAJMËRIMIN E
RASTEVE

GARANTIM
ANONIMITETI
DHE REAGIM
I SHPEJTË

APLIKACIONI
“LAJMËRO POLICINË”
ËSHTË PLATFORMË
ELEKTRONIKE

MUNDËSI
E DËRGIMIT
TË TEKSTEVE,
FOTOVE
DHE VIDEOVE

RAPORTO
NË 24 ORË



BASHKËPUNIM,
PARTNERITET,
TRANSPARENÇË

Më 24 qershor 2020, u lancua Aplikacioni “Lajmëro Policinë”, ky projekt është edhe një mundësi tjetër alternative për qytetarët për raportim sa më të shpejt dhe efikas të rasteve të ndryshme dhe avancimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dhe komunikimit me Policinë e Kosovës.